

LIGJ
Nr. 85/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME VENDIN PRITËS NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS RAJONALE PËR BASHKËPUNIM RINOR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 15.11.2018

Shpallur me dekreten nr. 10983, datë 27.11.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJA E VENDIT PRITËS
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS RAJONALE PËR
BASHKËPUNIMIN RINOR

Republika e Shqipërisë, që në vijim do të quhet “Vendi Pritës” dhe Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor, që në vijim do të quhet “ZRBR”, të dyja në vijim do të quhen “Palët”;

Referuar në “Marrëveshjen për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor”, nënshkruar në Paris, më 4 korrik 2016;

Duke theksuar që Marrëveshja bën të mundur vendosjen e Selisë së Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor në Tiranë, në Republikën e Shqipërisë;

Me vullnetin për të rregulluar privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për funksionimin dhe realizimin me sukses të misionit të ZRBR-së;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshje:

a) **“Palë Kontraktuese”** do të thotë një Palë Kontraktuese e “Marrëveshjes për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor”;

b) **“ZRBR”** do të thotë Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor;

c) **“Sekretariati”** do të thotë Sekretariati i ZRBR-së;

d) **“Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendëssekretari i Përgjithshëm”** do të thotë një person i emëruar si Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i ZRBR-së;

e) **“Personel Ndërkombëtar”** do të thotë anëtar i personelit të Sekretariatit, i cili nuk mund të jetë shtetas i Vendi Pritës, dhe as qytetar i huaj me vendbanim të përhershëm në Vendi Pritës;

f) **“Personel Vendës i Punësuar”** do të thotë një anëtar i personelit të Sekretariatit, që është shtetas i Vendi Pritës, ose një qytetar i huaj me vendbanim të përhershëm në Vendi Pritës;

g) **“Anëtar i Familjes”** do të thotë bashkëshorti/ja, fëmijët e pamartuar deri në moshën 18 vjeç, dhe të moshës 18 deri 23 vjeç nëse ata janë duke ndjekur studimet e plota akademike në Vendi Pritës, personat me aftësi të kufizuara nën kujdestarinë e anëtarit të Personelit Ndërkombëtar, nëse ata jetojnë në Vendi Pritës në të njëjtën shtëpi me Sekretarin e Përgjithshëm, Zëvendëssekretarin e Përgjithshëm, Përfaqësues dhe anëtarë të Personelit Ndërkombëtar dhe që nuk janë qytetarë të vendit pritës apo nuk kanë vendbanim të përhershëm në Vendi Pritës;

h) **“Ekspert i Kontraktuar”** do të thotë një person që po kryen një mision të përkohshëm për ZRBR-në, dhe është kontraktuar nga kjo e fundit;

i) **“Ambientet e ZRBR-së”** do të thotë ambientet e përdorura nga ZRBR-ja, duke përfshirë dhe truallin e përdorur për qëllime sekondare, të zënë dhe të përdorur ekskluzivisht për qëllimet e ZRBR-së.

Neni 2

Selia e ZRBR-së

Selia e ZRBR-së është në Tiranë, në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë. Qeveria e Vendit Pritës do t'i sigurojë ZRBR-së, pa pagesë, lehtësitë e nevojshme dhe ambientet e përshtatshme siç parashikohet në Marrëveshjen për ZRBR-në dhe Statutin e saj si pjesë integrale e Marrëveshjes.

Neni 3

Personaliteti juridik

ZRBR-ja, e themeluar si një organizatë ndërkombëtare, do të gëzojë personalitet juridik të plotë sipas legjislacionit shqiptar dhe do të ketë cilësitë e duhura juridike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të saj, si lidhjen e kontratave, përfitimin dhe përdorimin e pasurive të tundshme dhe të patundshme, nisjen dhe ndjekjen e procedimeve ligjore.

Neni 4

Logoja dhe emërtimet

1. ZRBR-ja mund të përdorë flamurin e saj, logon dhe simbole të tjera në ambientet e saj dhe në automjetet e ZRBR-së.

2. Automjetet e ZRBR-së duhet të kenë regjistrim diplomatik dhe statusin përkatës sipas legjislacionit të Vendit Pritës.

Neni 5

Imunitetet dhe privilegjet e ambienteve

1. ZRBR-ja do të gëzojë imunitetet dhe privilegjet që i garantohen të gjitha misioneve diplomatike të akredituara në Vendin Pritës.

2. Ambientet e ZRBR-së do të jenë të paprekshme.

3. Vendi Pritës do të garantojë paprekshmërinë e Selisë së ZRBR-së. Autoritetet kompetente të Vendit Pritës do të kenë të drejtë të hyjnë në ambientet e ZRBR-së për të kryer detyrat e tyre vetëm me miratim nga Sekretari i Përgjithshëm i Sekretariatit, apo nga një zyrtar tjetër i Sekretariatit në detyrë, i autorizuar. Megjithatë, në rast rënie zjarri apo emergjencash të ngjashme, miratimi për të drejtën e hyrjes do të merret i mirëqenë nëse lind nevoja për masa mbrojtëse të menjëhershme.

4. Dokumentet dhe materialet e arkivuara të ZRBR-së, përfshirë dhe gjithë pajisjet kompjuterike dhe dokumentet digjitale që gjenden në këto pajisje që i përkasin ZRBR-së, do të jenë të paprekshme.

5. Qeveria e Vendit Pritës do të marrë të gjitha masat për të mbrojtur ambientet e ZRBR-së ndaj çdo hyrje me forcë apo dëmtim, prishje të qetësisë dhe dhunim të dinjitetit të ZRBR-së.

Neni 6

Publikimet

Importimi dhe eksportimi i publikimeve, si dhe i materialeve të tjera informuese të importuara apo eksportuara nga ZRBR-ja për përdorim zyrtar, nuk do të kenë asnjë lloj kufizimi.

Neni 7

Përfshirja nga tatimet dhe taksat

1. ZRBR-ja, asetet e saj, të ardhurat dhe prona të tjera, do të jenë të përjashtuara nga taksat direkte kombëtare dhe vendore. Ky përjashtim nuk do të aplikohet për taksat dhe fonde që konsiderohen si pagesa për shërbimet publike të ofruara sipas tarifave të vendosura, në bazë të sasisë së shërbimit të marrë, që mund të identifikohet, përshkruhet dhe ndahet.

2. Përfshirja nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH-ja) i përfshirë në çmime apo faturuar më vete, do të aplikohet vetëm mbi një sasi të arsyeshme të artikujve dhe shërbimeve të blera për përdorim zyrtar nga Sekretariati. Në këtë rast mallrat e blera për përdorim nga Sekretariati, për të cilat aplikohen përjashtimet sipas kësaj dispozite, nuk mund të shiten, të dhurohen apo të asgjësohen në asnjë mënyrë përveç në kushtet e rena dakord me Qeverinë e Vendit Pritës.

3. ZRBR-ja do të jetë e autorizuar të importojë pa detyrime doganore, në sasi të arsyeshme mallra për përdorim zyrtar, përfshirë dhe automjete.

Neni 8

Përdorimi i fondeve

ZRBR-ja, me qëllim kryerjen e funksioneve të saj, ka të drejtën të marrë, mbajë, shkëmbejë, transferojë të gjitha fondet, monedhat, paratë kesh, dhe t'i përdorë në liri dhe në përputhje me rregullat e Vendit Pritës me të njëjtat kushte si misionet e tjera diplomatike.

Neni 9

Kontributet individuale ndaj ZRBR-së

Kontributet e bëra nga individë apo entitete private për ZRBR-në nuk do të jenë subjekt i imuniteteve diplomatike.

Neni 10

Sigurimet shoqërore

1. Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendëssekretari i Përgjithshëm dhe stafi ndërkombëtar do të përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme që lidhen me çdo lloj sigurimi shoqëror në Vendin Pritës.

2. Personeli vendës i punësuar do të jetë subjekt i të gjitha detyrimeve për kontributet në përputhje me legjislacionin e Vendit Pritës.

Neni 11

Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i ZRBR-së

Gjatë gjithë mandatit të tij në Vendin Pritës, Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i ZRBR-së do të gëzojnë imunitetet dhe privilegjet që ju garantohen krerëve të zyrave të ngjashme të organizatave ndërkombëtare në Vendin Pritës, bazuar në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, 1961.

Neni 12

Imunitetet dhe privilegjet e përfaqësuesve dhe Personelit Ndërkombëtar

Në kohën e kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në territorin e Vendit Pritës, Përfaqësuesit dhe stafi ndërkombëtar, me përjashtim të rasteve kur janë qytetarë të Vendit Pritës, ose qytetarë të huaj me banim të përhershëm në Vendin Pritës, do të gëzojnë në Vendin Pritës imunitetet dhe privilegjet e mëposhtme:

a) Imunitet nga juridiksioni penal i Vendit Pritës lidhur me të gjitha veprimet e kryera prej tij/saj në funksionin e tij/saj zyrtar, përfshirë dhe për fjalët e folura/shkruara;

b) Imunitet nga juridiksioni civil dhe administrativ, me përjashtim të rasteve, të:

1. Një veprimi nga ana e tij/saj lidhur me zotërimin e një prone të patundshme private që ndodhet në territorin e Vendit Pritës, përveç nëse e zotëron këtë pronë në emër të ZRBR-së për qëllimet e misionit;

2. Një veprimi lidhur me një trashëgimi për të cilën Personeli Ndërkombëtar figuron si zbatues i testamentit, administrator, trashëgimtar, si person privat dhe jo në emër të ZRBR-së;

3. Një veprimi lidhur me një aktivitet profesional apo tregtar, të ushtruar nga Personeli Ndërkombëtar në Vendin Pritës, jashtë funksioneve të tij zyrtare.

c) Paprekshmëri të të gjitha dokumenteve dhe shkresave zyrtare të tij/saj;

d) Paprekshmëri të bagazheve zyrtare të tij/saj;

e) Përjashtimi nga të gjitha taksat dhe detyrimet lidhur me pagat dhe shpërblimet e tyre të marra nga RYCO-ja;

f) Përjashtim të tij/saj dhe anëtarëve të familjes së tij/saj nga kufizimet që lidhen me emigrimin dhe regjistrimin e të huajve;

g) Të drejtën për të importuar pa detyrime doganore mobiliet dhe sendet personale të tij/saj me efekt në marrjen e parë të detyrës, si edhe për të rieksportuar të njëjtat mobilie pa detyrime doganore;

h) Të drejtën për të importuar automjetet e tij/saj për përdorim personal dhe po ashtu për t'i rieksportuar pa detyrime doganore.

Neni 13

Personeli Vendës i Punësuar

1. Personeli Vendës do të punësohet në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi të Vendit Pritës.
2. Personeli Vendës i Punësuar, mbështetur në këtë Marrëveshje, do të gëzojë vetëm imunitet nga juridiksioni për veprime që lidhen me kryerjen e funksioneve të tyre, përfshirë fjalë të thëna apo të shkruara në cilësitë e tyre zyrtare.

Neni 14

Ekspertët e kontraktuar

Gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në territorin e Vendit Pritës, Ekspertët, me përjashtim të rasteve kur janë qytetarë të Vendit Pritës, ose qytetarë të huaj me vendbanim të përhershëm në Vendin Pritës, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet si më poshtë:

- a) Imunitet nga juridiksioni për veprime që lidhen me kryerjen e funksioneve të tyre, përfshirë fjalë të folura ose të shkruara, në cilësitë e tyre ligjore;
- b) Paprekshmëri të të gjitha shkresave zyrtare, të dhënave të materialeve të medias dhe dokumenteve;
- c) Përjashtim nga kufizimet për emigrimin sipas rregullave të Vendit Pritës;
- d) Përjashtimi nga të gjitha taksat dhe detyrimet lidhur me pagat dhe shpërblimet e tyre të marra nga RYCO-ja.

Neni 15

Përjashtim nga imuniteti

Pa paragjykuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, është detyra e të gjithë personave që gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në këtë marrëveshje që të respektojnë ligjet dhe rregullat e Vendit Pritës.

Neni 16

Heqja e imunitetit

1. Privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në këtë Marrëveshje nuk janë garantuar që zyrtarët e ZRBR-së t'i gëzojnë ato për përfitim personal, por me qëllimin që të kenë mbrojtjen e duhur për të ushtruar të pavarur funksionet e tyre.

2. Me kërkesë më shkrim nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, drejtuar Sekretariatit të ZRBR-së, Sekretari i Përgjithshëm mund t'i heqë imunitetin stafit të ZRBR-së dhe Bordi Drejtues mund t'i heqë imunitetit Sekretarit të Përgjithshëm në çdo rast ku në opinionin e tij, imuniteti do të pengojë punën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykuar dhe në interes të ZRBR-së. Heqja dorë e imunitetit nga juridiksioni duhet të shprehet gjithmonë me shkrim.

3. Heqja e imunitetit nga juridiksioni për një procedim administrativ, nuk duhet të mbahet dhe të nënkuptojë dhe heqje të imunitetit për zbatimin e masave të një vendimi. Në këtë rast ka nevojë për një heqje tjetër imuniteti.

Neni 17

Njoftimi

Sekretariati i ZRBR-së duhet t'i dërgojë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Vendit Pritës:

- a) Listën e Personelit Ndërkombëtar dhe të anëtarëve të familjeve të tyre që jetojnë me ta, menjëherë ose maksimumi brenda tre ditëve nga data e mbërritjes së tyre;
- b) Sekretariati i ZRBR-së duhet të dërgojë njoftim për mbarimin e mandatit të Përfaqësuesve ose Personelit Ndërkombëtar të deklaruar sipas paragrafit "a" dhe, nëse është e nevojshme, të dërgojë njoftim edhe nëse një person nuk është më anëtar i familjes që banon në shtëpinë e tyre;
- c) Përfaqësuesit dhe Personeli Ndërkombëtar të deklaruar sipas paragrafit të mësipërm dhe anëtarët e familjeve të tyre që jetojnë me ta, do të pajisen me dokumente identifikimi të lëshuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Vendit Pritës në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 18

Përgjegjësitë e Vendit Pritës

Vendi Pritës nuk do të mbahet përgjegjës për veprime apo gabime të Sekretariatit dhe personelit të tij, brenda territorit të tij.

Neni 19

Çështje të sigurisë

1. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk përjashton të drejtën e Qeverisë së Vendit Pritës të marrë gjithë masat e duhura mbrojtëse në interes të sigurisë publike. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk mund të pengojë zbatimin e ligjeve të Vendit Pritës, të cilat janë të nevojshme për ruajtjen e rendit dhe mirëqenies publike.

2. Nëse Qeveria e Vendit Pritës e sheh të domosdoshme të ndërmarrë masat referuar në paragrafin 1 më sipër, sapo rrethanat ta lejojnë, duhet të kontaktojë Sekretariatën me qëllim marrjen e një vendimi të përbashkët për masat e nevojshme që duhen marrë për mbrojtjen e interesit të ZRBR-së.

3. Sekretariati ka detyrim të bashkëpunojë me autoritetet e Vendit Pritës me qëllim shmangien e çdo lloj cenimi të sigurisë publike që mund të shkaktohet nga ndonjë aktivitet i ZRBR-së.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet konsultimit dhe bisedimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese.

2. Autoriteti kompetent për të zgjidhur mosmarrëveshjet private dhe administrative ndërmjet ZRBR-së dhe entiteteve private do të jetë gjykata në vendin ku ZRBR-ja ka selinë e saj.

Neni 21

Ndryshimet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e përbashkët të Palëve. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi sipas nenit 22 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën që Republika e Shqipërisë njofton Sekretariatën që të gjitha detyrimet ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur. Një kopje e këtij njoftimi do t'u dërgohet të gjitha Palëve Kontraktuese.

Neni 23

Ndërprerja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi me afat të papërcaktuar.

Secila nga Palët mund të tërhiqet nga marrëveshja aktuale me anë të një njoftimi me shkrim. Tërheqja do të hyjë në fuqi 6 muaj pasi Pala tjetër ka marrë njoftimin për ndërprerjen e Marrëveshjes.

Neni 24

Depozitari

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të veprojë si Depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

Dokumenti origjinal i kësaj Marrëveshjeje do të depozitohet te Depozitari që do t'u përcjellë një kopje të certifikuar ZRBR-së dhe gjithë Palëve Kontraktuese.

Bërë në , më në dy origjinalë në gjuhën angleze.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PËR ZYRËN RAJONALE PËR BASHKËPUNIMIN RINOR

**HOST COUNTRY AGREEMENT
BETWEEN
THE REPUBLIC OF ALBANIA
AND
THE REGIONAL YOUTH COOPERATION OFFICE**

The Republic of Albania, hereinafter referred to as the "Host Country", and Regional Youth Cooperation Office, hereinafter referred to as the "RYCO", both referred to as "The Parties";

Referring to the "Agreement on the establishment of the Regional Youth Cooperation Office", signed in Paris, on 4 July 2016;

Noting that the Agreement provides for the establishment of the Seat of the Regional Youth Cooperation Office in Tirana, Republic of Albania;

Wishing to regulate the privileges and immunities necessary for the functioning and successful accomplishment of the mission of the RYCO;

Have agreed as follows:

Article I Definitions

For the purposes of this Agreement:

- a) **"Contracting Party"** means a Contracting Party to the "Agreement concerning the establishment of the Regional Youth Cooperation Office
- b) **"RYCO"** means the Regional Youth Cooperation Office;
- c) **"The Secretariat"** means the Secretariat of RYCO;
- d) **"The Secretary General and Deputy Secretary General"** shall mean a person appointed as Secretary General and Deputy Secretary General of RYCO;
- e) **"International Staff"** means a staff member of the Secretariat, provided that they are neither a citizen of the Host Country, nor a foreign citizen with permanent residence in the Host Country;
- f) **"Locally Recruited Staff"** means a staff member of the Secretariat, who is a citizen of the Host Country, or a foreign citizen with permanent residence in the Host Country;
- g) **"Family Member"** means a spouse, unmarried children up to the age of 18 and of age 18 till 23 provided that they are following full academic studies in the Host Country, persons with disabilities under the custody of the member of the International Staff, provided that they live in the Host Country in the same household with the Secretary General, Deputy Secretary General and member of the International Staff and that they are not citizens of the Host Country or foreign citizens with permanent residence in the Host Country;
- h) **"Contracted Expert"** means a person performing a temporary mission for RYCO, contracted by the latter;
- i) **"Premises of RYCO"** means the premises including the land ancillary thereto, occupied by RYCO and used exclusively for the purposes of RYCO;

Article 2
The Seat of RYCO

The Seat of RYCO is in Tirana, the capital of the Republic of Albania. The Government of the Host Country shall provide RYCO at no fee the necessary facilities and appropriate premises as provided for in the RYCO Agreement and its Statute, as an integral part of it.

Article 3
Legal Personality

RYCO, established as an international organization, shall enjoy full legal personality under the Albanian law and shall have the legal capacity necessary for carrying out its functions so as to conclude contracts, to acquire and dispose of movable and immovable property and to establish and pursue legal proceedings.

Article 4
Logo and designations

1. RYCO may display its flag, logo and other symbols on its premises and on motor vehicles of RYCO.
2. Motor vehicles of RYCO shall be entitled to diplomatic registration and a relevant status according to the Host Country legislation.

Article 5
Immunities and privileges of premises

1. RYCO will enjoy the immunities and privileges granted to all diplomatic missions accredited in the Host Country.
2. The Premises of RYCO shall be inviolable.
3. The Host Country shall guarantee that the Seat of RYCO is inviolable. The competent authorities of the Host Country shall be entitled to enter the premises of RYCO in order to perform their duties only with the consent of the Secretary General of the Secretariat, or a duly authorized official of the Secretariat. However, in the event of fire or similar emergency, such consent shall be deemed to have been granted if immediate protective measures are required.
4. Documents and archival materials of RYCO, including all computer applications and digital files belonging to it or in its possession, shall be inviolable.
5. The Government of the Host Country shall undertake all measures to protect the premises of RYCO against any intrusion or damage, disturbance or violation of dignity of RYCO.

Article 6
Publications

Import and export of publications, as well as of other information materials imported or exported by RYCO for its official use, shall not be subject to limitations of any sort.

Article 7
Exemption from duties and taxes

1. RYCO, its assets, income and other property shall be exempt from national and local direct taxes. This exemption shall not apply to taxes and appropriations which are deemed to be charges for utility services offered according to the established rates, according to the quantity of services delivered, which can be identified, described and divided.
2. With regard to the value added tax included in prices or charged separately, exemption shall apply only to the reasonable quantities of articles purchased and services delivered for the official use by the Secretariat, in which case the goods purchased for its use, in respect to which exemptions apply in accordance with this provision, may not be sold, given away or disposed of in any other way, except under conditions agreed with the Government of the Host Country.
3. RYCO shall be entitled to import duty and customs free, reasonable quantities of goods for its official use, including motor vehicles.

Article 8
Disposal of Funds

RYCO shall, for the purpose of carrying out its functions, have the right to receive, keep, exchange, transfer all funds, currencies, cash and dispose of freely therewith, in accordance with the regulations of the Host Country under the same conditions as provided for diplomatic missions.

Article 9
Individual contributions to RYCO

Contributions made by individuals and private entities to RYCO shall not be subject to diplomatic immunities.

Article 10
Social security

1. The Secretary General, Deputy Secretary General and the International Staff shall be exempted from paying obligatory contributions in connection to any type of social security in the Host Country.
2. The locally recruited staff shall be subject to all obligatory contributions in accordance with the legislation of the Host Country.

Article 11
Secretary General and Deputy Secretary General of RYCO

Throughout his term of office in the Host Country, the Secretary General and the Deputy Secretary General of RYCO shall be enjoy immunities and privileges granted to heads of similar offices of international organizations in the Host Country, based on Vienna Convention on Diplomatic Relation, 1961.

Article 12
Immunities and privileges of the International Staff

While performing their official functions in the territory of the Host Country the International Staff, unless they are citizens of the Host Country, or foreign citizens with permanent residence in the Host Country, shall enjoy the following immunities and privileges in the Host Country:

- a) immunity from criminal jurisdiction of the Host Country in respect of all acts performed by him/her in his/her official capacity, including words spoken or written,
- b) immunity from its civil and administrative jurisdiction, except in the case of:
 1. A real action relating to private immovable property situated in the territory of the Host Country, unless he holds it on behalf of RYCO for the purposes of the mission;
 2. An action relating to succession in which the International Staff is involved as executor, administrator, heir or legatee as a private person and not on behalf of RYCO;
 3. An action relating to any professional or commercial activity exercised by the International Staff in the Host Country outside his/her official functions;
- c) inviolability of all official papers and documents,
- d) inviolability of his/her official baggage,
- e) exemption from all taxes and charges with respect to their salaries and emoluments received by RYCO,
- f) exemption in respect of him/her and members of his/her family forming a part of his/her household from immigration restrictions and aliens registration,

- g) the right to import free of duty his/her furniture and personal effects at the time of first taking up his/her function and to re-export the same free of duty,
- h) the right to import his/her private motor vehicle for his/her own personal use and subsequently re-export such vehicle free of duty.

Article 13 **The Locally Recruited Staff**

1. The Locally Recruited Staff shall be employed in accordance with the applicable legislation of the Host Country.
2. The Locally Recruited Staff shall, by virtue of this Agreement, enjoy only immunity from jurisdiction for acts carried out by them in the discharge of their functions, including words spoken or written, in their official capacity.

Article 14 **Contracted Expert**

While performing their official functions in the territory of the Host Country, Experts, unless they are citizens of the Host Country, or foreign citizens with permanent residence in the Host Country, shall enjoy the following privileges and immunities:

- a) immunity from jurisdiction for acts carried out by them in the discharge of their functions, including words spoken or written, in their official capacity;
- b) inviolability of all official papers, media data and documents;
- c) exemption from immigration restrictions in accordance with regulations of the Host Country”;
- d) exemption from all taxes and charges with respect to their salaries and emoluments received by RYCO.

Article 15 **Exemption from immunity**

Without prejudice to their privileges and immunities, it is the duty of all persons enjoying the privileges and immunities provided for in this agreement, to respect the laws and regulations of the Host Country.

Article 16
Waiver of immunity

1. Privileges and immunities provided for in this Agreement are not granted for the personal benefit of RYCO officials enjoying them, but in order to safeguard the independent exercise of their functions.
2. Upon the written request of the Ministry for Europe and Foreign Affairs of the Host Country to the Secretariat of RYCO, the Secretary General shall waive the immunity of RYCO's staff and the Governing Board shall waive the immunity of Secretary General in any case where in its opinion the immunity would impede the course of justice and can be waived without prejudice to the interest of RYCO. The waiver of immunity from jurisdiction must always be expressed in writing.
3. The waiver of immunity from jurisdiction in respect of administrative proceedings shall not be held to imply the waiver of immunity in respect of the enforcement of judgment, for which a separate waiver shall be necessary.

Article 17
Notification

The Secretariat of RYCO shall provide to the Ministry for Europe and Foreign Affairs of the Host Country:

- a) The list of the International Staff, and of their family members forming part of their respective households, immediately or within three days of the date of their arrival at the latest;
- b) The Secretariat of RYCO shall also provide notification on the expiration of the term of office of any International Staff notified in accordance with paragraph (a), and, as may be necessary, that a person ceased to be family member of their respective households.
- c) The International Staff notified in accordance with the preceding paragraph and their family members forming part of their respective households will be provided with identity services card issued by the Ministry for Europe and Foreign Affairs of the Host Country in accordance with the Albanian legislation.

Article 18
Liability of the Host Country

The Host Country shall not be held responsible for any actions or omissions committed by the Secretariat and of its staff within its territory.

Article 19
Security issues

1. Nothing in this Agreement shall exclude the right of the Government of the Host Country to take all relevant measures of protection in the interest of public safety or to prevent the implementation of the laws of the Host Country, which are necessary for the maintenance of public health and order.
2. If the Government of the Host Country considers that the application of the provisions referred to in paragraph 1 above is necessary, as soon as the circumstances permit, it shall contact the Secretariat so as to make a joint decision on measures that may be necessary to protect the interests of RYCO.
3. The Secretariat shall be obliged to cooperate with the authorities of the Host Country so as to avoid any harm to public security resulting from any activity of RYCO.

Article 20
Settlement of disputes

1. All disputes regarding implementation and interpretation of this Agreement shall be resolved through negotiations between the Parties.
2. The competent authority to settle disputes of a private and administrative nature between RYCO and private entities and individuals will be the court where RYCO has its Seat.

Article 21
Amendments

This Agreement may be amended by mutual consent of the Parties. The amendments shall enter into force in accordance with Article 22 of this Agreement.

Article 22
Entry into force

This Agreement shall enter into force on the date of notification of the Republic of Albania to the Secretariat that all necessary legal requirements for entry into force of this Agreement have been fulfilled. A copy of this notification shall be send to all Contracting Parties.

Article 23
Termination

This Agreement shall remain in force indefinitely.

Any Party may denounce the present Agreement by means of notification. Such denunciation shall take effect six months after the date of receipt by the other Party of such notification.


Article 24
Depositary

The Government of Republic of Albania shall act as Depositary of this Agreement.

The original of this Agreement shall be deposited with the Depositary which shall transmit a certified copy to RYCO and all Contracting Parties.

Done in TIRANA on 28.8.2008 in two originals in the English language.

**FOR THE REPUBLIC OF
ALBANIA**



**FOR THE REGIONAL YOUTH
COOPERATION OFFICE**

